REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13891/8 Prot.

Lezhë, më 08. 09. 2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në datën 08.09.2026, në orën 11:00, në Bibliotekën "Gjergj Fishta" Lezhë, mbi dëgjesën publike në lidhje me projekt vendimin "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar shoqërisë "F K Energy" shpk, për vendosjen e antenës për matjen e rezultateve të erës në Malin e Rrencit, Njësia Administrative Shëngjin dhe për vendosjen e antenës për matjen e rezultateve të erës në Malin e Kakarriqit, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë".

Takimi u hap nga anëtari i Kryesisë së Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Erin Ndreca.

-Erin Ndreca: Përshëndetje të gjithëve. Ky është takimi i dytë në lidhje me dëgjesën publike për projektvendimin në fjalë, pasi në datën 20.08.2026 nuk u realizua për shkak të mospjesëmarrjes së komunitetit dhe grupeve të interesit.
Bëhet fjalë për një projektvendim që është përgatitur nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve që është "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar shoqërisë "F K Energy" shpk, për vendosjen e antenës për matjen e rezultateve të erës në Malin e Rrencit, Njësia Administrative Shëngjin dhe për vendosjen e antenës për matjen e rezultateve të erës në Malin e Kakarriqit, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë".
Në lidhje me këtë p/vendim kemi prezent dhe specialistin nga bashkia z. Artan, i cili mund të na flasë më gjerë, pastaj shtrojmë diskutimet. Faleminderit.

-Artan Palushi: Përshëndetje të gjithëve. Unë jam përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në D.B.U.A.P, Bashkia Lezhë. Lidhur me këtë projektvendim ne kemi patur një kërkesë nga kompania "F K Energy" shpk dhe në vijim të kësaj kërkese ne kemi zhvilluar një shpallje në ëeb-in e bashkisë, ku ka qendruar e hapur për një periudhë kohe siç e parashikon ligji dhe gjatë kësaj periudhe është pritur që të dorëzohen kërkesat nga palët e interesuara. Në fund të procesit është administruar vetëm një kërkesë që ka ardhur nga kompania "F K Energy" shpk për matjen e rezultateve të erës dhe në zbatim të dokumentacionit që ka dorëzuar kompania kemi parë hartën mbi të cilën ka vendosur pikat ku shpreh interesin, dmth pikat ku vendosen antenat dhe gjurmët e rrugës që jepet në përdorim në funksion të këtij aktiviteti që zhvillohet për një vit. Pra kjo antenë është një antenë e zakonshme që mat rezultatet e erës. Aty janë vendosur edhe më përpara antena të tilla nga një kompani italiane. Bashkia i ka kërkuar kompanisë që të bëjë edhe ca gjëra shtesë që t`i bëjë edhe për bashkinë, që i kemi

cilësuar, që janë temperatura, drejtimi e shpejtësia e erës. Në fund të këtij procesi ajo do dorëzojë një studim të plotë për të gjithë faktorët që lidhen me klimën, plus ajo që është me interes prej saj, që është matja e shpejtësisë së erës, me synimin për ta parë në të ardhmen për ndërtimin e një parku eolik. Duke marrë në studim hartën që ka dorëzuar kompania, është parë që gjurma e antenës dhe rrugët bien në sipërfaqe pyjore që i janë transferuar bashkisë me VKM dhe pikërisht për këtë , është e rëndësishme që komuniteti të jetë prezent dhe të dëgjojë se për çfarë bëhet fjalë, se shumëkush mund të ketë pretendime që është toka ime, është toka e të parëve, siç i kemi pretendimet ne nëpër fshatra, dhe për çdo rast kur ka pretendime, duhet sigurisht që të shoqërohet me dokument pronësie. Pra burokracia që i përmbahemi ne është lista e inventarit të transferuar me VKM Bashkisë Lezhë. Sigurisht për këtë do pyetet këshilli bashkiak që do ia japë apo jo dhe për një vit kompania thjesht do kryejë studimin. Mbas një viti mbaron marrja në përdorim, dorëzon studimin. Sigurisht që janë përcaktuar tarifat që njeh VKM-ja për përdorimin dhe kompania do paguajë vlerën e kontratës për dhënien në përdorim. Kjo procedurë ka mbështetje ligjore në aktet që ne i kemi përcaktuar te P/vendimi.

-Milton Ivanaj, kr. Fshati Mali i Rrencit: Ajo antenë që është vu, është vu në tokën time. Tokën e kam me dy vendime gjykate. Kulla është tash 100 e ca vjet. E kam dosjen, jua paraqes kur të doni ju. Mua njerëzit e mi më kanë thanë mos me lshu firmë. Edhe rruga e vjetër nuk është aty, me kooperativën e kanë ba sa me i ra ma shkurt.

-Esat Dushku, kr. Fshati Mali i Shëngjinit: Ky është një eksperiment faktikisht por pretendohet ma vonë me u ba investimi. Ligji e quan tokë shtetërore, e bashkisë. Gjithë banorët e asaj zone kanë shtëpitë e vjetra, kanë qenë banorë autoktonë dhe gjithçka e kanë në procedurë, gjithsecili prej tyre ka pretendime. Ata nuk është se janë kundër projektit, por janë kundër mënyrës se si do investohet sepse ata do ngelen të përjashtuar. Me të vertetë e ka pasë Ministria e Bujqësisë dhe i ka kalu bashkisë, por nuk do të thotë se ata nuk janë pronarë atje, përderisa çdo gja e kanë në proces dhe për këtë kanë kundërshti. Problemi tani është krejt i vogël me problemin që mund të vijë ma vonë. Te investimi mund të dalin probleme se ata kundërshtojnë. Ne jena në proces dhe jena të përjashtuar, ne jena tu marrë letrat, si do zgjidhet kjo punë. Kjo është problematika. Banorët e kanë konsumu dhe me administratorin. Ne kena gjithçka, janë shpiat, janë muret, janë varrezat. Dokumentacionin nuk e kanë marrë akoma por e kanë në procedura. Të gjithë e kanë nga një gjë, vërtetim gjykate, vërtetime arkivore.

-Erin Ndreca: Dëgjesat për këto arsye bëhen. Shqetësimet janë të drejta dhe sa më shumë të thuhen, aq më shumë dëgjohen. Nga këto lloj investimesh patjetër që ka në të gjithë rajonin, në të gjithë botën. Është mënyra më e pastër e prodhimit të energjisë.
Ne bëjmë dëgjesën publike, paraqesim në këshill ato që dëgjojmë këtu dhe është këshilli ai që vendos. Të gjithë pretendojmë që kemi toka, se kështu ka qenë historia jonë, por ama ligji dhe shteti njeh pronësinë. Unë nuk mund ta them dot që njohja që të ka bërë gjykata ty quhet pronësi apo jo. Atë janë organet kompetente që do e shqyrtojnë. Ligji prevalon mbi të gjitha këto, që do të thotë, nëse kjo tokë i ka kaluar shtetit, atëherë shteti ka të drejtë që ta përdorë, ta japë në përdorim.
Tani është faza e parë e matjes dhe nëse vendoset që do investohet, patjetër që do bëhet dëgjesë tjetër.

-Skënder Ulaj, nj.a.Balldre: Mali i Rrencit dhe Mali i Kakarriqit kanë qenë zona të banuara. Unë di njerëz që kanë ba letra, që janë në procese gjyqësore. AKP nuk ka njohur procedurën. Nuk është faji i qytetarit, s`ia njeh. Problemi është se nesër do hasim me debate. Logjika është se si do arrihet marrëveshje. Problemi është që të vazhdohet me ligjshmëri.

-Erin Ndreca: Jam shumë dakord me të gjitha shqetësimet, por ju thashtë diçka, prevalon ligji. Nëse ti nuk paraqet një certifikatë pronësie, por ti e pretendon, është ligji ai që përcakton nëse do vazhdojnë apo nëse do pritet.

-Skënder Ulaj, nj.a.Balldre: E dinë edhe zogjtë e malit që x-i ka jetu në atë vend. Janë në prona të veta, në procese gjyqësore, me të gjitha dokumentacionet dhe nuk thotë AKP-ja çfarë do bëhet me këta njerëz. Ligji duhet t`ua njohë pronat.

-Erin Ndreca: Këtu jemi në një dëgjesë nga ana e bashkisë. Institucioni që thua ti është tjetër.
Nuk është se nuk e besoj unë atë që thua ti. Nëse ligji thotë që është ashtu si thua ti, ok, do bëhet ashtu si thua ti. Deri në momentin që ti t`i vërtetosh pretendimet e tua, kjo është tokë shtet.

-Skënder Ulaj, nj.a.Balldre: Po nëse AKP-ja nuk do me ua kthy?

-Erin Ndreca: Nuk funksionon ligji sipas dëshirës. Për momentin faktet thonë që është pronë shtet. Prandaj po bëjmë dëgjesën, që të dëgjojmë pretendimet tuaja. Do i paraqesim dhe do vendosë këshilli bashkiak.

-Artan Palushi: Duhet sqaruar diçka. Ky momenti që po flasim ne, nuk flet asgjë për ndërtimin e parkut. Ajo vjen mbrapa sigurisht. Për momentin po flasim për një studim që është një antenë krejt e vogël, që ju e njihni çfarë antene është, që është për matjen e rezultateve të erës. Jeta nuk ndalohet deri në ndërtimin e parkut, jeta ecën para në fazat e veta. Supozojmë se deri kur të ndërtohet parku, nqs do bëhet, psh në lidhje me pretendimet e Miltonit, i hiqet pronësia bashkisë dhe i kalon Miltonit. Atëherë, Miltoni, nqs do ketë interes, e zhvillon marrëdhënien drejtpërdrejt me kompaninë.

-Erin Ndreca: Që të mos e zgjasim, po bëhet fjalë për një studim. Ndërkoë mund të zgjidhen dhe problemet e pronësisë.

-Artan Palushi: Ky proces nuk synon të zhbëjë vendimet e gjykatës apo proceset e kthimit/kompensimit të pronave. Nuk po kthehem të përsëris ato gjëra që i thashë.

-Erin Ndreca: Ka dikush tjetër diçka për të thënë? Nuk ka. Ju falenderoj për pjesëmarrjen.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

Anëtari i Kryesisë së KB Lezhë
ERIN NDRECA